



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:201865
Datë: 08.11.2024
Numri i dokumentit: 06427849

PPP.nr.249/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përbarimore me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunatorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (Kesco) me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, ..., kundër debitorit A.V me adresë në rr.”...”-Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej ... gjykata duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori me datë ..., kundër Urdhrit për lejimin e Përbarimit, gjykata jashtë seancës me datën 08.11.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit A.V nga Mitrovica, ushtruar kundër urdhërit mbi lejimin e përbarimit P.nr.... të datës ..., sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (Kesco) me seli në Prishtinë.
- II. Mbetet në fuqi Urdhëri Përbarimor P.nr.... i datës ..., i lejuar nga Përbaruesi Privat, ... i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Arsyetim

Kreditori, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (Kesco) me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit kundër debitorit A.V me adresë në rr.”...”-Mitrovicë, për pagesën e borxhit në emër të energjisë elektrike të harxhuar për periudhën kohore ... deri me ..., në shumë totale prej ... me kamatë prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura në shumën e kërkuar të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përbarim të datës

Organi përbarues me Urdhrin P.nr.... i datës ..., e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori A.V nga Mitrovica, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdhërin për përbarim për shkak se në bazë të të cilave është marr vendimi përbarues nuk janë të përshtatshme për përbarim. Më tutje shton se në propozimin për përbarim është paraqitur kërkesa për borxh të vjetërsuar ngase i njëjti borxh është vjetërsuar

në kuptim të dispozitave të LMD-së, neni 360 paragrafi 1.1. Andaj i propozoj Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të refuzohet urdhëri përmbarimor.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori Kompania Kosovare për Furnizimi me Energji Elektrike (KESco) me seli në Prishtinë, ka paraqitur përgjigje në prapsim, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar dhe të paargumetnuar përmes asnjë provë. Propozimi për përmbarim është bërë në përputhje me nenin 29 dhe 40 të LPP-së, kurse sa i përketë parashkrimit, ky pretendim nuk qëndron pasi që kreditori në propozimin për përmbarim ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej ... deri ... në shumë prej Kërkesa për prapësim nuk është në harmoni me nenin 69 të LPP-së, andaj Gjykatës i propozon që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit P.nr.... i datës

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përketë pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se urdhëri për përmbarim në bazë të të cilave është marr vendimi përmbarues nuk është i përshtatshëm për përmbarim, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka iniciuar në bazë të faturës, e sipas nenit 29 paragrafi 1.3 në lidhje me paragrafi 3 të LPP-së, fatura konsiderohet dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbarim, po ashtu në shkresat e lëndës gjenden transaksionet e konsumatorit ku janë të specifikuara si data, numri, vendi, harxhimet, vlera në euro, pagesat eventuale si dhe borxhi i përgjithshëm.

Lidhur me pretendimet e debitorit në prapësim se borxhi është parashkruar, gjykata gjeti se i njëjti nuk është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit për këtë periudhë kohore, pasi që kreditori në Propozimin për Përmbarim të datës ..., ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej ... deri me ... në shumë prej ... Tutje, tek transaksionet e debitorit shihen pagesa të kryera, me ç'rast me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit-Ex Lege, ky fakt shkakton ndërprerjen e parashkrimit, ku në bazë të nenit 368, paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së, parashihet se *"1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit."*

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbarim këtë fakt gjykata, e mbështetë në nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së i cili nen parasheh se *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se *"Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak"*.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 paragrafi 1.3 dhe paragrafi 3, 69, 71, 73 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e në lidhje me nenin 245 paragrafi 1 dhe 2, 360, 368 paragrafi 1 dhe 2, dhe neni 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.249/2023, datë 08.11.2023

GJYQTARI
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.